



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

NËNTOR 2025

Tiranë më 30.11.2025

1	03.11.2025	a) A keni të dhëna të dokumentuara mbi dëmin mjedisor që aktivitetet minerare të kompanive në Fushë-Arrëz, Librazhd dhe Selenicë kanë shkaktuar në tokë, ujë dhe ajër?	13.11.2025	<p>Brenda fushës së veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit, referuar VKM-së Nr.568/2019 "<i>Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit</i>", më poshtë gjeni përgjigjen</p> <p>Në kuadër të transparencës publike dhe në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014, "<i>Për të drejtën e informimit</i>", i ndryshuar, lidhur me masat ndëshkimore, administrative ose parandaluese të ndërmarra nga ana jonë ndaj kompanive përgjegjëse për ndotjen e lumit Shkumbin që ARM Berat-Elbasan-Korçë mbulon, ju bëjmë me dije sa vijon:</p> <p>Spektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore pranë ARM-së Berat,Elbasan,Korçë ushtron kryesisht inspektime mbi subjektet që shfrytëzojnë burime ujore sipërfaqësore ose nëntokësore për</p>	Përfunduar	Nuk ka
---	------------	--	------------	--	------------	--------

	<p>b)Për lumenjtë Fan, Shkumbin dhe Vjosë, cili ka qenë roli juaj pas konstatimit të ndotjes dhe cilat masa ndëshkimore, administrative ose parandaluese janë marrë ndaj kompanive përgjegjëse?</p> <p>c) A ekzistojnë raporte të rregullta për nivelet e ndotjes dhe për mënyrën se si menaxhohen mbetjet minerare?</p> <p>d) Në rastin e mbetjeve minerare të trashëguara në Kukës, cilat hapa konkretë janë</p>		<p>qëllime biznesi, me synim verifikimin e zbatimit të kërkesave të Ligjit Nr. 29/2024, “Për Burimet Ujore”, si dhe kontrollin e respektimit të kushteve të përcaktuara në lejet përkatëse që këto subjekte disponojnë , për përdorimin e burimeve ujore.</p> <p>Sa i përket kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore nuk ka informacion për ndotjen e lumit nga aktivitetet minerare dhe si rrjedhojë nuk janë vendosur masa ndëshkimore, administrative ose parandaluese.</p> <p>Masa administrative për veprimtari të ndaluara në lumin Shkumbin janë vendosur subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore pa lejen përkatëse. Subjektet ndaj të cilat janë vendosur masa administrative janë:</p> <p>Vëllezërit ***** G**** shpk I*****</p> <p>Bashkangjitur po ju dërgojmë një kopje të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit të kryer në këto subjekte.</p> <p>Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë ka kryer inspektime në disa subjekte të cilat me veprimtarinë e tyre mund të jenë potencialisht ndotëse në lumin "Vjosë".</p> <p>Bashkangjitur po ju dërgojmë procedurat e inspektimeve ku janë të specifikuar gjetjet, masat administrative të marra dhe detyrat e lëna.</p> <p>Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës bën me dije si vijon:</p> <p>a)A keni të dhëna të dokumentuara mbi dëmin mjedisor që aktivitetet minerare të kompanive në Fushë-Arrëz, Librazhd dhe Selenicë kanë shkaktuar në tokë, ujë dhe ajër?</p> <p>-Në lidhje me minierën Fushë-Arrëz dhe Kukës po ju paraqesim informacionin që disponojmë, bazuar në Raportin e Gjendjes në Mjedis 2021.</p> <table border="1" data-bbox="787 1242 1444 1429"> <thead> <tr> <th data-bbox="787 1242 1039 1429">Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri</th> <th data-bbox="1039 1242 1228 1429">Sasia potenciale e mbetjeve që ato kanë të depozituara</th> <th data-bbox="1228 1242 1444 1429">Përshkrimi i gjendjes</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="787 1429 1039 1461"></td> <td data-bbox="1039 1429 1228 1461"></td> <td data-bbox="1228 1429 1444 1461"></td> </tr> </tbody> </table>	Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri	Sasia potenciale e mbetjeve që ato kanë të depozituara	Përshkrimi i gjendjes					
Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri	Sasia potenciale e mbetjeve që ato kanë të depozituara	Përshkrimi i gjendjes									

	ndërmarrë në bashkëpunim me institucionet e tjera për pastrimin e zonës dhe minimize-min e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës?	Zona e minierës së bakrit Fushë Arrëz	N/A	Një nga zonat më të mëdha të minierave të bakrit në vend, e cila prodhonte rreth 320,000 Mt/vit xeheror bakri (kur operonte me kapacitet të plotë).
		Zona e minierave të bakrit Kalimash/Kukës, Gjegjan	N/A	Zonë e minierës së bakrit , ku përqëndrime të arsenikut shkarkohen në ujrat e Drinit të mesëm. Zona e Gjegjanit raportohet të jetë më e ndotura.
<p>Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035.</p> <p>b) <i>Për lumenjtë Fan, Shkumbin dhe Vjosë, cili ka qenë roli juaj pas konstatimit të ndotjes dhe cilat masa ndëshkimore, administrative ose parandaluese janë marrë ndaj kompanive përgjegjëse?</i></p> <p>-për lumin Fan, kemi pasur ankesë nga banorët e zonës në Nëntor të vitit 2023 për subjektin B**** sh.a, është ngritur grupi i inspektimit dhe pas verifikimit në terren, grupi i inspektimit ka konstatuar ndotje për shkak të shkarkimeve të pakontrolluara, dhe për rrjedhojë ka marrë masë administrative 1.000.000 (një milion) Lekë si dhe është kërkuar pezullim</p>				

			<p>aktiviteti si masë plotësuese nga ana jonë (me të cilin kemi qenë dhe në proces gjyqësor).</p> <p>Gjithashtu ju informojmë se Raportet e Gjendjes në Mjedis publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit www.akm.gov.al , https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/ për informimin e publikut të gjërë mbi gjendjen mjedisore në vendin tonë dhe rekomandimet për përmirësim.</p> <p>Institucione të ndryshme si Ministritë, Agjencitë, Bashkitë etj, informohen për publikimin e Raportit të Gjendjes në Mjedis nëpërmjet dërgimit të Raportit të Gjendjes në Mjedis si dhe broshurës përmbledhëse të gjendjes në mjedis dhe veprimet për përmirësim.</p> <p><i>c)A ekzistojnë raporte të rregullta për nivelet e ndotjes dhe për mënyrën se si menaxhohen mbetjet minerare?</i> -Po, subjektet e paisura me Leje Mjedisit të Tipit A dhe B, dërgojnë në AKM në mënyrë të vazhdueshme Raporte Vetmonitorimi për Lejet e Tipit A, cdo 3-muaj + Raportin Vjetor dhe Lejet e Tipit B, cdo 6 muaj + Raporti Vjetor.</p> <p><i>d)Në rastin e mbetjeve minerare të trashëguara në Kukës, cilat hapa konkretë janë ndërmarrë në bashkëpunim me institucionet e tjera për pastrimin e zonës dhe minimizimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës?</i> -nuk kemi dijeni për rastin në fjalë, pasi menaxhimi i territoreve bëhet nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, Bashkia Kukës.</p> <p>Në rast se ju nevojitet informacion për subjekte të caktuara, Ju lutemi të na vini në dispozicion të dhënat e plota të subjektit (emrin dhe NIPT-in përkatës), në mënyrë që të mund të verifikohet nëse ndaj është marrë apo jo masë administrative për shkarkime të paligjshme ose ndotje të shkaktuar në lumin Shkumbin.</p>		
--	--	--	--	--	--

2	05.11.2025	<p>1-Kemi hulumtuar në terren për venddepozitimet e mbetjeve minerare Kukës, Fushë-Arrëz, Selenicë, Librazhd dhe në zona të tjera ku mbetjet minerare përfundojnë në lumenj. Nga komunikimi me banorët e zonës së Kukësit, informohemi që banoret po i mbledhin mbetjet dhe po i shesin tek një kompani në Kosovë. Nëse kjo është e vërtetë, a është në dijeni institucioni juaj?</p> <p>2-Nëse po, a është pajisur subjekti me</p>	10.11.2025	<p>Në vijim të informacionit të kërkuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, referuar VKM-së Nr.568/2019 "<i>Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AKM-së</i>", brenda fushës së veprimtarisë dhe kompetencës ka trajtuar pyetjet e mëposhtëme.</p> <p>Ashtu si jeni bërë me dije edhe nëpërmjet e-mailit të ditës 5.11.2025, pyetjet e tjera i janë deleguar AKBN-së, AMBU-së dhe AKEM-it për trajtim sipas fushës së veprimtarisë.</p> <p>2-Operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C dhe licenca të nënkategorisë III.2.B janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 "<i>Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë</i>". Në linkun e mëposhtëm mund të verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B: https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/ Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, ka për qëllim të sigurojë aksesin e lirë të publikut në përputhje me ligjin. Gjithashtu ju informojmë se në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar lista e subjekteve të pajisura me leje mjedisi periudha 2014-Tetor 2025: https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/ https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-periudhen-2012-maj-2024/ Për një informacion më të saktë mbi operatorët të pajisur me leje mjedisi Ju duhet t'i drejtoheni QKB-së e cila mban dhe administron regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve. 4-Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka kryer monitorimin e ujërave sipërfaqësor të baseneve Shkumbin, Drin, Vjosë dhe Mat për parametrat fiziko -kimik si dhe monitorimin e ujërave</p>	Përfunduar	Nuk ka
---	------------	---	------------	---	------------	--------

		<p>leje mjedisore dhe licencë nga MM dhe AKM për pastrimin e mbetjeve minerare?</p> <p>3-A janë respektuar të gjitha kërkesat për depozitimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve minerare dhe trajtimin e ujërave që dalin nga objektet minerare dhe ato të depozitimit të mbetjeve në të gjitha zonat ku mbetjet përfundojnë nëpër lumenj?</p> <p>4-Kur ka bërë monitorimin e ujërave të lumenjve Shkumbin, Fan, Vjosë dhe Drin institucioni</p>		<p>të lumenjve, Shkumbin, Drin dhe Vjosë për radioaktivitetin alfa total dhe beta total.</p> <p>Bazuar mbi Raportin e Gjendjes në Mjedis 2024, vlerësohet se ujërat e baseneve Shkumbin, Vjosë dhe Mat (ku përfshihet lumi Fan i Madh dhe Fan i Vogël) për parametrat fiziko- kimik i përkasin kategorisë, Klasa II- Gjendje e mirë, pra nuk paraqesin ndotje. Ujërat e Basenit të Drinit i përkasin kategorisë, Klasa III – Gjendje e moderuar, klasa kufi e pranimit të cilësisë të ujërave.</p> <p>Përsa i përket vlerave të radioktivitetit alfa dhe beta total të ujërave të lumenjve Shkumbin, Drin dhe Vjosë, vlerësohet se janë nën vlerat e përcaktuara në standartet kombëtare dhe nuk paraqesin ndotje.</p> <p>Për më shumë informacion , Ju lutem, shikoni Raportin e Gjendjes në Mjedis 2024 në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit www.akm.gov.al , https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/ .</p>		
--	--	---	--	--	--	--

	<p>juaj dhe cilat janë vlerat e cilësisë së ujërave?</p> <p>5-Për rastin e Fushë Arrëzitet, a ka një monitorim nga ana juaj, cilat janë dëmet dhe nëse ka pasur shkelje, cila është masa administrative e vendosur ndaj subjektit privat ? E njëjta pyetje vlen edhe për raste të tjera të ngjashme (Selenicë etj)</p> <p>6-Për hotspotet e trashëguara, a ka marrë ndonjë masë rehabilitimi MM? Nëse po, ku kanë qenë zonat dhe sa ka qenë</p>				
--	---	--	--	--	--

		<p>investimi financiar?</p> <p>7-Në venddepozitimet e mbetjeve minerare, a ka pasur impakt në faunën dhe florën dhe sa ka qenë ndikimi i tyre në shëndetin e njeriut dhe të mjedisit?</p>				
3	06.11.2025	<p>1.Më informoni për veprimet dhe inspektimet e kryera nga Bashkia Lushnjë dhe/ose ARM pas marrjes së shkresës së delegimit.</p> <p>2.Të më paraqiten kopje të cdo raporti, procesverbali apo dokumenti zyrtar të inspektimeve</p>	25.11.2025	<p>Në përgjigje të kërkesës për informacion ardhur nga ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë, mbi hapat që janë ndjekur dhe masat e ndërmarra, mbi ankesën e bërë, në lidhje me ndotjen e pretenduar të mjedisit nga tymrat ndotës, erërat e pakëndshme dhe mbetjet e lëndëve djegëse, nga subjekti “A*** T***” që ushtron aktivitetin si baxho në lagjen “Toli” të fshatit “Toshkëz”, Allkaj, Lushnjë.</p> <p>Ankesë e cila dilte jashtë kompetencave inspektuese të institucionit tonë dhe i është përcjell për kompetencë dhe marrje masash Bashkisë Lushnjë me shkresën Nr. 2728 Prot. datë 06.09.2023, e cila i është njoftuar për dijëni dhe ankuesit.</p> <p>Në mungesë të kompetencës, institucioni ynë nuk ka kryer dhe nuk mund të kryete veprime inspektimi, pasi subjekti nuk ka një leje mjedisi të vlefshme. Sipas informacionit të marrë nga sektorët përkatës, nuk rezulton të ketë informacione të tjera mbi ankesën në fjalë apo subjektin e lartpërmendur.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>të kryera në terren, me Nr.prot dhe datë, si nga ana e Bashkisë Lushnjë ashtu dhe nga ana e ARM.</p> <p>3.Të paraqiten të gjitha masat e marra ndaj subjektit, përfshirë dhe gjoba nëse janë vendosur, me kopjet përkatëse të akteve të konstatimit të vendimeve.</p> <p>4.Të më vihen në dispozicion të gjitha kopjet e dokumenteve që Bashkia Lushnjë ka dërgaur në përgjigje të shkresës Nr.2728 prot datë 06.09.2023.</p> <p>5.Të paraqitet dosja e plotë e</p>		<p>Bashkëlidhur gjeni "Për delegim kompetence, Bashkisë Lushnjë".</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		subjektit “A*** T***” që ndodhet në arkivën tuaj, përfshirë dokumentacio -nin teknik, mjedisor dhe inspektimet e kryera ndër vite.				
4	25.11.2025	1-Duke qenë se ligji Nr.57/2025 “Për <i>menaxhimin e integruar të mbetjeve</i> ” ka hyrë në fuqi së fundmi dhe nuk parashikon në mënyrë të shprehur vazhdimin e efekteve të VKM-së Nr.957/2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” na sqaroni se si parashikohet aktualisht të rregullohet menaxhimi i	27.11.2025	Në vijim të informacionit të kërkuar nga ana juaj, Ju bëjmë me dije si vijon: Bazuar në nenin 82 " <i>Aktet nënligjore</i> ", të ligjit Nr.57/2025 " <i>Për menaxhimin e integruar të mbetjeve</i> ", Këshilli i Ministrave brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerr aktin nënligjor në zbatim të Nenit 52 " <i>Baterritë dhe mbetjet e baterive</i> " dhe nenit 54 " <i>Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike</i> ". Gjithashtu ligji " <i>Për Përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje</i> " ku janë të përfshira edhe rrymat e cituara më lart është në fazën finale të miratimit në parlament.	Përfunduar	Nuk ka

	<p>mбетјеve nga pajisjet elektrike dhe elektronike dhe cilat janë detyrimet konkrete të subjekteve importuese /prodhuese në kuadër të këtij kuadri të ri ligjor.</p> <p>2-Nëse VKM Nr.957/2012 vijon të zbatohet, na sqaroni si realizohet në praktikë regjistrimi i prodhuesve /importuesve të PEE-ve dhe cila kategori e lejes së mjedisit zbatohet në rastin konkret duke qenë se terminologjia e VKM Nr.957/2012 nuk është e qartë.</p>				
--	---	--	--	--	--

		<p>3-Në vijim, duke qenë se menaxhimi i baterive, akumulatorëve dhe mbetjeve të tyre rregullohet nga VKM Nr.866/2012 “Për bateritë, akumulator-ët dhe mbetjet e tyre” ju lutemi të na sqaroni nëse kjo VKM vijon të jetë në fuqi pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr.57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe nëse po, cilat janë detyrimet specifike si importues i pajisjeve që përmbajnë bateri/akumulatorë.</p>				
5	27.11.2025	<p>Në lidhje me aplikimin e subjektit “Korporata Elektro-</p>	27.11.2025	<p>Referuar kërkesës për informacion në lidhje me subjektin “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare” sh.a, , për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidrocentrali i Skavicës”, me vendodhje në luginën e Drinit të Zi.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>energjitike Shqiptare” sh.a në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidro-centrali i Skavicës”, me vendodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjektit të cilit i është refuzuar automatikisht nga sistemi i e_lejeve, pas tejkalimit të afatit ligjor, desha të di nëse:</p> <p>1. subjekti Koorporata Elektro-energjetike Shqiptare sh.a ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar?</p>		<p><i>1.Nese subjekti Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a ka riaplikuar për kryerjen e procedurës sëVNM-së së Thelluar.</i></p> <p>-Subjekti nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

